



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



## Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 702/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

### V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.579/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji “Riinvest” për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.572/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.572/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji “Riinvest”:
  - Menaxhim Biznesi, BA, 180 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve në programet e cekura në pikën dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.572/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Riinvest” me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 572/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegji “Riinvest” i është pezulluar akreditimi për programet e studimit: Menaxhim Biznesi, BA, 180 ECTS, dhe Inxhinieri Softuerike, MSc, 120 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji “Riinvest”, është konstatuar që programi i cekura në pikën dy të këtij vendimi, akreditimi i të cilit është pezulluar me vendim të KSHC-së nr.572/17, datë 06.07.2017, tani i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2.

Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Riinvest";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

